

**KUVENDI I KOMUNËS SË VUSHTRISË**

**RREGULLORE  
PËR SHËRBIMET E VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE  
MIRËMBAJTJËN E VARREZAVE TË QYTETIT**

---

**Maj 2006**

Mbështetur në nenin 3 alineja 3.1 pika "II" dhe nenin 4 alineja 4.1 të Rregullores nr. 2000/45 Mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nenin 27 alineja 1 pika "p" dhe nenin 28 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 25.05.2006 miratoi këtë:

## **RREGULLORE MBI SHËRBIMET E VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJËN E VARREZAVE TË QYTETIT**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen çështjet e rregullimit dhe mirëmbajtjes së varrezave si dhe shërbimet e varrimit në varreza, në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave është veprimtari komunale me interes të përgjithshëm.

#### Neni 2

##### **Përkufizime**

Shpjegime të kuptimeve të fjalëve që përdoren në këtë rregullore:

**Varr** - vendi për varrosjen e trupit (eshtrave) të vdekur.

**Varrim** - vendosja e eshtrave të kufomës në vendin e caktuar.

**Varrezë** – është toka e caktuar për varrim e përcaktuar sipas planit urbanistik të qytetit.

**Vende për varrim** – është toka e caktuar për varrezë me gjithë lapidar (përmendore)

**NSHV** – Ndërmarrja për shërbimet e varrimit.

**Shërbimet e varrimit** - shërbimet të cilat kryhen gjatë procedurës së varrimit.

**Shfrytëzuesi i vend-varrit** - person i cili përkujdeset për vend-varr.

**Leje për zhvarrosje** - leje të cilën e lëshon Organi kompetent i komunës për zhvarrosjen e të vdekurit.

**Çmimi i varrimit** - çmim i propozuar nga biznesi dhe i aprovuar nga Kuvendi komunal i Vushtrrisë, për mirëmbajtje dhe shërbime të varrimit.

**Prehja** – pushimi shpirtërorë i të vdekurit.

**Dinjitet** - tërësia e vlerave morale të të vdekurit.

**Person** - person juridik ose person fizik.

**DSHP** - Drejtoria për Shërbime Publike.

**KKV** - Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

### **II. RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTA E VARREZAVE**

#### Neni 3

Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave nënkupton rregullimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe mjeteve të cilat shërbejnë për kryerjen e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe

mirëmbajtjen e rrugëve, aleve dhe hapësirave ndërmjet varreve, mirëmbajtja e gjelbërimit, rendit dhe pastërtisë, largimi i borës dhe akullit, përgatitja e hapësirës për varrim si dhe kryerja e punëve tjera të cilat janë të lidhura me rregullim dhe mirëmbajtje të varrezave e varreve në veçanti.

#### Neni 4

Në qytet si dhe në vendbanimet tjera në territorin e Komunës, duke pasur parasysh se jetojnë pjesëtarë të konfesioneve të ndryshme, mund të jenë në përdorim dy ose më shumë lokacione për varreza.

#### Neni 5

Toka (lokacioni) për varreza në qytet caktohet në përputhje me planin urbanistik të qytetit, ndërsa në vendbanime tjera, në territorin e Komunës, në përputhje me planin hapësinor.

Para caktimit të vendit (lokacionit) për varreza duhet pasur kujdes veçanërisht në mbrojtjen e burimeve dhe puseve prej nga banorët furnizohen me ujë, në mbrojtjen e ajrit si dhe mbrojtjen e kushteve të posaçme sanitare për ndërtimin e varrezave.

#### Neni 6

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, bazuar në planin urbanistik të qytetit dhe me vendim të veçantë, përcaktoi lokacionin për varreza të reja të qytetit në zonën kadastrale Begaj, fleta poseduese, nr.92 me sipërfaqe prej 12.36.44 ha.

#### Neni 7

Në bazë të planit urbanistik dhe projektit të varrezave, hapësira në varreza e dedikuar për varrosje, ndahet në parcela në brendi të cilave ndodhen vendet për varrim, të cilat evidentohen me numra. Vendet për varrim dizajnohen në madhësi maksimale 240x120 cm. me gjithë lapidar. **Distanca në mes varrezave duhet të jetë 50 cm.**

**Arkitektura e vendeve për varrim rregullohet në bazë të planeve rregullative detale dhe Rregullotrës së veçantë të Bashkësive fetare.**

NSHV- është e obliguar që të udhëheq dhe evidentoj ngastrat dhe vendet e varrit me emrin e personave të vdekur, datën e varrimit si dhe shërbimet tjera të lidhura me varrim.

#### Neni 8

Kuvendi i Komunës sipas procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës (tokës) komunale, duke u bazuar në procedurën e ligjit mbi prokurim, përzgjedh përfituesin i cili do të jetë përgjegjës për menaxhim dhe mirëmbajtje të varrezave të qytetit.

NSHV kryen shërbime sipas dispozitave të kësaj rregulloreje në përputhshmëri me çmimin e propozuar nga biznesi përmes DSHP dhe të aprovuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

#### Neni 9

Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave bëhet në bazë të programit vjetor të cilin e propozon NSHV e të cilën e miraton Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

Përkujdesje të veçantë Kuvendi Komunal do t'i kushtojë Varrezave të dëshmorëve në territorin e Komunës së Vushtrrisë

Programi nga paragrafi 1 i këtij neni përmban: llojin, masën, dinamikën e punëve, si dhe shumën e mjeteve të nevojshme për realizimin e tyre.

NSHV është e obliguar që Drejtorisë për inspektion t'ia paraqes planin për mirëmbajtje të zbërthyer në muaj për vitin vijues, më së largu 10 ditë pas miratimit të programit nga paragrafi 1. Planet harmonizohen me programin e aprovuar nga KKV.

#### Neni 10

Për mirëmbajtjen e vendeve të varrit përkujdesën shfrytëzuesit, familja e afërt dhe farefisi. Rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrit, shfrytëzuesit mund të ja besojnë mirëmbajtjen e varrit, NSHV e cila i mbikëqyrë varrezat.

#### Neni 11

NSHV gjatë mirëmbajtjes duhet domosdo t'i përmbahet rregullave dhe projektit të varrezave. Ndryshimet eventuale mund t'i bëjë NSHV vetëm me pëlqim të DSHP dhe aprovim të KKV.

#### Neni 12

Të drejtat dhe përgjegjësitë e NSHV përcaktohen me kontratë të veçantë. Kuvendi komunal mbanë të drejtën që në rast të mosrespektimit të elementeve të kontratës të shkëputë kontratën.

#### Neni 13

Për vendosjen, riparimin si dhe zhvendosjen e pllakave dhe mjeteve tjera në vendet e varrit është i obligueshëm pëlqimi i NSHV.

Për ndërmarrjen e çfarëdo pune në lapidarë (pllakë përkujtimore) ose ndonjë pjese në varr ose varrezë, e cila ka karakterin e lapidarit kulturor, është i nevojshëm pëlqimi me shkrim nga institucioni i cili merret me mbrojtjen e monumenteve kulturore.

NSHV është i obliguar që ta informojë Drejtorinë e inspektionit për ekzekutimin e punëve pa pëlqim nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni.

#### Neni 14

Aktivitetet zejtare në varr, për të cilat është siguruar pëlqimi bazuar në neni 14 të kësaj rregulloreje kryhen duke i respektuar këto kritere:

1. Në ditë pune, gjatë aktiviteteve të mbahet rendi dhe qetësia në varrezave.
2. Materiali ndërtimor (rëra, cement etj.) është i lejuar të mbahen në varreza për një kohë sa më të shkurtër e cila është e nevojshme për kryerjen e punëve e që mos të jetë pengesë për lëvizjen e vizitorëve, pas mbarimit të punëve ekzekutuesi është i obliguar që menjëherë vendpunimin ta kthejë në gjendjen e mëparshme.
3. Transporti i materialit të bëhet vetëm në rrugët dhe aletë të cilat i përcakton NSHV.
4. Nëse gjatë kryerjes së punëve gjinden arkivole dhe gjëra të tjera, punët duhet të ndërpriten dhe menjëherë duhet lajmëruar NSHV.
5. Nëse gjatë kryerjes së punëve gjinden mjetet me vlerë menjëherë duhet dorëzuar NSHV.
6. NSHV mund të ndërpresë punët në varreza apo në një pjesë të varrezave në kohë të caktuara të ditës, apo në ditë të caktuara.

7. Ekzekutuesve të punëve të cilët nuk i përmbahen dispozitave të këtij neni, udhëzimit për respektimit të rendit në varreza, NSHV ua ndalon aktivitetin ndërtimor në varreza.

#### Neni 15

NSHV është e obliguar të mënjanoj të gjitha mjetet dhe të mbjellurat të cilat janë të vendosura pa pëlqim. Shpenzimet për punët e ndërmarra do të jenë në ngarkesë të shfrytëzuesit të varrit.

#### Neni 16

Në varreza është e lejuar mbjellja e luleve dekorative të rritjes së ulët të cilat nuk pengojnë varret tjera për rreth.

Drunjtë e mbjellur nga Kuvendi i Komunës mund të mënjanohen, krasiten vetëm me pëlqim nga DSHP.

#### Neni 17

NSHV që mena xhon me varreza të qytetit është i obliguar që:

1. Aktivitetet të jenë në pajtueshmëri me projektin e aprovuar për rregullim të varrezave.
2. Në bazë të projektit dhe përpunimit detaj urbanistik të bëjë përcaktimin e vendeve për varrim.
3. Të mirëmbajë rrugët, aletë, hapësirën ndërmjet varreve.
4. Të kujdeset për mirëmbajtjen dhe mos dëmtimin e rrethojës.
5. Përkujdesje të veçantë tu kushtojë varrezave të dëshmorëve.
6. Në fund të çdo viti kalendarik të hartojë planin e punëve për vitin e ardhshëm, dhe si Propozim t'ia dorëzoj Drejtorisë për Shërbime Publike, gjegjësisht Kuvendit për miratim.
7. Qytetarëve t'ua jep në shfrytëzim vendin e lirë sipas radhës në varreza në pajtim me këtë rregullore
8. Të kryej shërbime në lidhje me varrimin dhe transportin e eshtrave (transporti, gërmimi)
9. Të mbaj librin amë të varrimit, posaçërisht për secilin varr, me përshkrim të hollësishëm të vendit (parcelës së varrimit).
10. Të mbaj evidencën e varrezave, lapidarëve etj.
11. Të mbajë evidencën e bartësit të së drejtës së shfrytëzimit të vendit-parcelës së varrimit
12. Të mbajë evidencën e parcelës së varrimit.
13. Të mbajë evidencën e varrezave të qytetarëve të merituar.
14. Të kryej punë tjera në mirëmbajtje, rregullim dhe mbrojtje të varrezave të cilat do të përcaktohen me kontratë.

### **III. VARRIMI**

#### Neni 18

Me varrim nënkuptohet varrosja e të vdekurit, përkatësisht vendosja e eshtrave të kufomës në vendet e caktuara.

Varrosja bëhet pasi të jetë konstatuar vdekja e përcaktuar me dispozita ligjore.

#### Neni 19

Pas konstatimit të vdekjes nga ana e mjekut, familja, përkatësisht personi që përkujdeset për varrosje është i obliguar që në afat prej tre orësh ta njoftojë biznesin për vdekjen e personit me qëllim të organizimit të bartjes dhe varrosjes në varreza të qytetit.

Organizimin komplet të varrimit, që nga bartja e bënë NSHV që mena xhon me varreza.

#### Neni 20

NSHV është e obliguar që bartjen e kufomës (që ka ndërruar jetë jashtë institucioneve shëndetësore) ta siguroj çdo ditë në kohën 00 deri 24. Bartja duhet të bëhet të njëjtën ditë kur nga ana e mjekut është konstatuar vdekja.

#### Neni 21

NSHV është e obliguar që të sigurojë çdo ditë personelin për shërbime të varrimit.

Personeli i cili bënë varrimin duhet që të ketë veshjen përkatëse të cilën e përcakton biznesi.

#### Neni 22

Vendi për varrim i jepet në shfrytëzim farefisit të ndjerit dhe atë: bashkëshortit të ndjerit, fëmijët (me kurorë, jashtë-kurorës, të falur) prindit të ndjerit etj.

Nëse nuk ka shfrytëzues nga paragrafi 1 i këtij neni vendi i varrit i jepet në shfrytëzim farefisit më të gjerë.

Kuvendi komunal do t'i mbulojë shpenzimet (sigurojë) e varrimit për qytetarët të cilët nuk kanë farefis dhe nuk kanë qenë nën përkujdesje prej askujt.

Përgjithësisht nga paragrafi 1 dhe 2 vendi i varrit i ipet në shfrytëzim personit i cili siguron varrimin e të ndjerit.

#### Neni 23

Në qytet kufoma bartet për në varr me arkivol (tabut) të cilën mund ta bart NSHV me mjete të caktuara motorike për këtë qëllim

Shfrytëzuesit e vendit të varrit janë të obliguar të bëjnë kompensimin për shfrytëzim, mirëmbajtje për çdo vit në pajtueshmëri me çmim të miratuar nga KKV.

#### Neni 24

Të drejtat dhe përgjegjësitë në mes të shfrytëzuesve dhe NSHV rregullohen me kontratë, e cila lidhet menjëherë ose më së voni brenda gjashtë muajve prej ditës së varrimit të të ndjerit.

Kontrata nga alineja 1 e këtij neni lidhet në afat të caktuar.

Vendi i varrit që është dhënë në shfrytëzim nuk mund të tjetërsohet.

#### Neni 25

Në rast të vdekjes së shfrytëzuesit e drejta për shfrytëzim bie në personin fizik i cili është pasardhës i tij.

Nëse janë disa persona si pasardhës, personat janë të obliguar të përcaktojnë shfrytëzuesin i cili duhet të dorëzojë dëshminë nga gjyqi, në të kundërtën këtë person do ta përcaktoj NSHV e cila menaxhon me varreza.

#### Neni 26

Varrosja bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse sanitare dhe fetare duke respektuar dinjitetin e të vdekurit.

Kufoma e të vdekurit nuk mund të zhvarroset, bartet nga varrezat ekzistuese para skadimit të afatit të obligueshëm sanitar.

Afati i obligueshëm sanitar i fillimit gjerë të hapja e varrit (zhvarrosja) është së paku 10 vjet.

#### Neni 27

Mihja dhe mbushja e varrit përkatësisht mbyllja e varrit në varreza të qytetit bëhet nga NSHV ndërsa në vendbanimet tjera këto punë u besohen bashkë familjarëve të ndjerit ose personave tjerë.

#### Neni 28

Eshtrat e kufomës të cilës i ka skaduar afati obligues i prehjes nuk mund të zhvarrohen në intervalin kohor prej 1 majit deri me 30 shtator.

#### Neni 29

Bashkë me kërkesën për varrim ose bartje të eshtrave të kufomës, paraqitësi i kërkesës është i obliguar të paraqesë dëshminë mbi pëlqimin e bashkë familjarëve më të afërt të të ndjerit ose personit të autorizuar për shfrytëzimin e varrit.

Për bartjen e eshtrave nga një varr në tjetrin, nevojitet leja e Organit kompetent të komunës, bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë këtë lëmi.

Pas mbarimit të ceremonisë së varrimit, përkatësisht varrosjes personeli që ka kryer punët është i obliguar që vendin e varrit ta rregulloj sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

#### Neni 30

Varrosja e kufomës së të ndjerit bëhet në varrezën e cila është në shfrytëzim të rregullt.

Përgjithësisht jashtë varrezave të cilat janë në përdorim mund të bëhet varrimi vetëm me lejen e organit kompetent të administratës komunale dhe të bashkësisë fetare përkatëse.

Vendi për varrim jashtë varrezave në përdorim të rregullt përcaktohet me plan urbanistik.

#### Neni 31

Nëse në varrezat ekzistuese nuk ka vend për varrim për shkak të zgjerimit të vendbanimit, për arsye sanitare ose varrezat ekzistuese nuk i përgjigjen kushteve, Kuvendi i Komunës merr vendime të cilin varrezat e tilla pushojnë të jenë në funksion të përdorimit.

Vendimin nga alineja 1 e këtij neni Kuvendi i Komunës e merr në bazë të të dhënave të komisionit të posaçëm profesional.

#### Neni 32

Varrezat të cilat karakterizohen si varreza jashtë përdorimit pas skadimit të afatit për përdorim **ato konservohen, periudha e konservimit të kompleksit të varrezave duhet të zgjatë prej 70 deri 100 vjet, pas këtij afati** mund të shndërrohen në park, brez gjelbërimi me vendim të veçantë të KKV.

Shfrytëzuesit e vendvarrimeve të varrezave të tilla për kohën e mbetur, kanë drejt shfrytëzimi në një vendvarrim tjetër.

#### Neni 33

Varret mund të jenë për person ose varre familjare.

Në varret për person varroset vetëm një person, kurse në varret familjare, varrosen më shumë të afërm të gjakut, me kusht që thellësia e varrit deri në skajin e sipërm të arkivolit të jetë së paku 0,90 m.

NSHV që menaxhon me varreza mund të lejojë varrimin në një varr të eshtrave të personit të vdekur që nuk bënë pjesë në radhën e personave nga alineja 1 e këtij neni me kërkesë ose në marrëveshje me personat që gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit.

#### **IV. RENDI NË VARREZA**

##### Neni 34

Në varreza mbahet rendi dhe qetësia absolute.

NSHV është i obliguar që të sigurojë mbajtjen e rendit dhe qetësisë absolute në varreza.

##### Neni 35

Varrezat janë të hapura për vizitorë çdo ditë pune dhe atë për periudhën prej:

1 prillit deri me 30 shtator prej orës 07 deri në ora 19,

1 tetor deri më 31 mars prej orës 07 deri në ora 18,

NSHV me pëlqim të DSHP në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyeshme, përkohësisht mund të bënë ndalesën e vizitorëve në varreza.

##### Neni 36

Vizitorët, shfrytëzuesit e vendvarrimit janë të obliguar t'i përmbahen urdhëresës, udhëzimeve të cilat i japin personat e autorizuar të NSHV .

Vizitorët janë të obliguar që të mbajnë qetësi gjatë vizitave në varreza e cila u përgjigjet dinjitetit dhe obligimit ndaj të ndjerëve.

##### Neni 37

NSHV me akt të veçantë mund të rregullojë kohën e kryerjes së varrimit e cila duhet të jetë konform kësaj rregulloreje.

##### Neni 38

Në varreza është e ndaluar:

1. Hyrja dhe dalja e vizitorëve jashtë kohës kur varrezat janë të hapura për vizitorë.
  2. Hyrja e fëmijëve të moshës nën 10 vjeçare pa përcjelljen e personave të rritur.
  3. Kalimi i rrethojës, shkelja e sipërfaqeve të gjelbëruara, thyerja e drunjve dhe këputja e luleve dhe bimëve tjera dekorative.
- Shkelja, njetosja dhe dëmtimin e vendeve të varrimit.
4. Prishja e qetësisë në varreza.
  5. Futja dhe kullosja e kafshëve në varreza.
  6. Ngasja e biçikletave në rrugë dhe ale, sipërfaqe të gjelbëruara, hedhja e luleve të vyshkura etj.
  7. Fotografimi me qëllim të kryerjes së shërbimeve komerciale pa lejen e NSHV.
  8. Shitjen e çfarëdo malli pa lejen e NSHV dhe hedhja e mbeturinave në varreza.
  9. Aktivitete ndërtimore pa lejen e NSHV.
  10. Montimi i ulëseve, rrethojave nëse nuk janë paraparë me projekt.
  11. Mbjellja e drunjve për rreth varrit pa pëlqimin e NSHV .

#### Neni 39

Udhëzimin dhe urdhëresën me të cilën parashihet rendi dhe qetësia sipas kësaj rregulloreje, NSHV është i obliguar që ta vendos në vend të dukshëm në hyrje të varrezës.

### **V. MJETET E NEVOJSHME PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE**

#### Neni 40

Mjetet për ndërtim, rregullim dhe mirëmbajtje të varrezave sigurohen nga buxheti komunal (nga kompensimi për shfrytëzimin e tokës ndërtimore), mjetet e NSHV që i menaxhon varrezat si dhe nga burimet tjera (donatorët etj.) në përputhshmëri me dispozitat ligjore.

Mjetet për kryerjen e shërbimeve për varrim sigurohen nga çmimi të cilin e paguajnë shfrytëzuesit e së të drejtës për varrim.

#### Neni 41

Varrimin dhe shërbimet tjera për varrim (transporti i të vdekurit, eshtrave, ruajtja, ceremonitë e varrimit) NSHV i kryen në bazë të përmbushjes së obligimeve që dalin nga kontrata për shfrytëzimin e vend-varrit. NSHV në bazë të shërbimeve të planifikuara kalkulon çmimin e shërbimeve të cilën ia propozon Kuvendit të Komunës përmes DSHP për aprovim.

Kompensimi i shërbimeve nga alineja 1 i këtij neni kryhen edhe me rastin e zhvarrosjes së eshtrave të të vdekurit.

#### Neni 42

Për rregullim, mirëmbajtje të objekteve në varreza, si dhe shfrytëzimin e shërbimeve në varreza (mirëmbajtja e rrugëve dhe aleve, hapësira në mes të vend-varreve, gjelbërimit, ndriçimit publik, rendit dhe pastërtisë), shfrytëzuesi paguan kompensim për shfrytëzim të vend-varrit.

Kompensimi nga alineja 1 e këtij neni përmbushet për periudhën një/pesë/dhjetë vjeçare më së largu në afat prej 30 ditësh nga dita e skadimit të afatit për të cilin është përmbush obligimi.

### **VI. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E KUVENDIT TË KOMUNËS**

#### Neni 43

Në raste të jashtëzakonshme kur vjen deri te çrregullimi ose ndalimi i kryerjes së punëve në rregullim dhe mirëmbajtje të varrezave për shkak të “fuqisë madhore”, NSHV është i obliguar që menjëherë pa hezitim të ndërmer aktivitete në eliminimin e shkaktarit të çrregullimit dhe atë:

1. Angazhon personelin që të evitohen shkaqet që çrregullojnë mirëmbajtjen dhe varrimin në varrezë.
2. Urgjentisht riparon dhe ndërmon instalimet dhe mjetet të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e punëve, mbron objektet komunale dhe mjetet nga prishjet dhe avaritë tjera.
3. Ndërmer masa tjera të cilat i përcakton DSHP.

#### Neni 44

Bazuar në alinenë 1 të nenit 44 të kësaj rregulloreje NSHV është i obliguar që krahas ndërmarrjes së masave të lajmërojnë DS HP për shkaqet e çrregullimit – ndalimit si dhe aktivitetet e ndërmarra.

DSHP në kuptim të alinesë 1 të këtij neni është e obliguar që menjëherë:

1. Jep urdhër për mbrojtjen e objekteve dhe pronës komunale të cilat janë të rrezikuara

2. Propozon masa për eliminimin e pasojave si dhe masa tjera me qëllim të vënies në Shërbim të shërbimeve komunale.
3. Mund të angazhoj NSHV tjetër për kryerje, rregullim, mirëmbajtje të varrezave deri në eliminimin e çrregullimeve.
4. Vërteton shkaqet, eventualisht përgjegjësitë për çrregullim si dhe përgjegjësin për kompensimin e dëmeve.

#### Neni 45

Në rast të ndalesës në kryerjen e shërbimeve në rregullim dhe mirëmbajtje të varrezave për shkak të grevës, NSHV është i obliguar që të sigurojë minimumin e punëve të përcaktuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

### VII. MASAT NDËSHKUESE

#### Neni 46

NSHV e cila menaxhon me varreza do të gjobitet për kundërvajtje prej 500 deri 1.000 € nëse:

- Vepron në kundërshtim me neni 7 alineja 2 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 9 alineja 1 dhe 3 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 11 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 17 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 18 alineja 2 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 21 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 23 alineja 1 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 24 alineja 3 të kësaj rregulloreje.

Personi përgjegjës i NSHV do të gjobitet prej 100-300 € nëse vepron në kundërshtim me alinenë 1 të këtij neni.

#### Neni 47

Në shumë prej 1.000 deri në 1.500 € do të ndëshkohet personi juridik për kundërvajtje nëse ekzekuton shërbime xjtare të ndaluara sipas neni 13 dhe neni 14 të kësaj rregulloreje dhe atë:

- Nëse nuk siguron pëlqimin me shkrim nga entit për mbrojtjen e monumenteve kulturore neni 13 alineja 2.
- Nëse vepron në kundërshtim me nenin 14 alineja 1.

Personi përgjegjës i NSHV do të gjobitet për kundërvajtje prej 100-300 € nëse vepron në kundërshtim me neni 14 alineja 1.

#### Neni 48

Personi fizik do të gjobitet prej 100-200 € për kundërvajtje nëse:

- Vepron në kundërshtim me neni 13 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 14 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 24 alineja 3 të kësaj rregulloreje.
- Vepron në kundërshtim me neni 38 të kësaj rregulloreje.

Neni 49

Personi juridik do të gjobitet në shumë prej 500 € ndërsa personi përgjegjës në shumën prej 250 € për kundërvajtje nëse zhvillon aktivitete në varreza pa pëlqimin e NSHV që menaxhon me varreza.

Personi fizik 100 € nëse vepron në kundërshtim me neni 14 të kësaj rregulloreje.

Personi fizik do të gjobitet në shumë prej 100-250 € në vepron në kundërshtim me neni 38 të kësaj rregulloreje.

Nëse NSHV nuk kryen obligimet konform të kësaj rregulloreje, Drejtoria për inspektion-inspekcioni i shërbimeve komunale, do të ngrejë procedurën për kundërvajtje në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Vushtrrisë.

### **VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

Neni 50

Shërbimet e bartjes së kufomës për në varreza të qytetit e bërë NSHV e cila menaxhon me varreza, ndërsa në fshatra varrimi bëhet sipas traditës.

Neni 51

Varrezat e vjetra të qytetit të konfesionit mysliman, dhe të krishterë në Vushtrri deri në skadimin e afatit të përdorimit konsiderohen edhe më tej varreza të qytetit dhe për të njëjtat do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 52

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për inspektion-inspekcioni për shërbime komunale dhe NSHV e cila menaxhon me varreza të qytetit.

Neni 53

**Deri në zgjedhjen e NSHV përgjegjës për menagjimin dhe mirëmbajtjen e varrezave këto punët do ti kryejnë Bashkësitë fetare sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.**

Neni 54

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

**Kryetari i Kuvendit  
Muharrem Shabani**